



Pas perplasjeve me policine dhe ndalimit te disa tifozeve kuqebllu, grupi "Vllaznit Ultras" ka vendosur te protestoje forcave te rendit duke nxjerre nje deklarate per shtyp dhe duke bojkotuar per nje afat te pacaktuar stadiumin. "Falenderojme lojtaret tane qe luajten mjaft mire me keto mundesi qe kemi. Ne nuk kerkojme mrekulli por vetem impenjim maksimal per peshen e madhe te emrit "Vllazni". Vllaznit Ultras si perhere ma te miret. Se dyti, nuk mund te qendrojme indiferent ndaj aktit dhe gjestit provokues nga lojtari i Skenderbeut, Gjergji Muzaka ne drejtimin tone dhe te te gjitha tifozave shkodran, gjest qe shkaktoi edhe tensionimin e situates. Kerkojme nga FSHF denimin perkates per gjestet e perseritshme antispoitive te ketij lojtari gjate ndeshjes. Telenovela vazhdon sikur te ishte e paracaktuar kesaj here futet ne rol "Policia Shqiptare" qe vetem "Polici" nuk mund te quhet se "Shqiptare" jo e jo. Pas ketij incidenti "Policia" shtohet me shume ne tribunen tone ndonese nga ne nuk u hodh asgje ne fushe (kjo edhe nga largesia e madhe e tribunes me fushen e lojes). Me pas "Policia" vazhdon provokimet tashme te zakonshme ne drejtimin tone, tekstualisht me fjalet: "Perse vini te shikoni keto "Legena", (fjala eshte per lojtaret e Vllaznise)". Nga e marrin te drejten te fyejne lojtaret tane, keta persona qe paguhen me taksat tona, me taksat e tifozave, me taksat e lojtareve qe fyejne? Per NE keta lojtare jane te paprekshem edhe nese klubi nuk u del per Zot, ata na kane NE, kane Tifozat. Nje tjetër incident teper i rende qe nuk mund te kaloje ne heshtje eshte dhuna fizike e ushtruar nga disa personave civil dhe "Policia" e Shkodres ne drejtimin tone, ku ka pasur edhe te lenduar, nga kjo dhune e Policise nuk jane perjashtuar as persona minoren. Jane arrestuar 9 antare te tifo-grupit tone ku jane mbajtur ne menyre te padrejte per 12 ore nen presion dhe terror psikologjik nga ana e Policise. Duke pare qe çdo ndeshje ne "Loro Boriçi", Policia e Shkodres kerkon te beje "te fortin" me ne, gjithashtu duke marre shkas dhe nga mos reagimi i Klubit te Futbollit Vllaznia dhe Bashkise Shkoder te cilet jane vene ne dijeni te ketyre fakteve, vazhdojne te mos marrin masa per ti ndaluar keto gjeste skandaloze, Vllaznit Ultras kane vendosur qe: - "Te bojkotojme çdo ndeshje e cila luhet ne Shkoder derisa ne tribunen tone nuk do te kete asnje Kafshe/Polic. Te cilet as ne vendet me te pa zhvilluara nuk qendrojne ne Tribune me Tifozat. Vllaznit do te perkrahin çdo sport tjetër ku luan Klubi Vllaznia, basket, volej, boks, futboll femra etj... Vllaznia eshte Krenaria jone! U bejme thirrje Drejtorit te K.f Vllaznia , Armir Grima, Bordit Drejtues dhe Bashkise Shkoder qe te marrin masa sa me shpejt, sepse pasojat e mungeses se mbeshtetjes tone gjate 90 min. nuk mund te kthehen mbrapa, sfida me te veshtira na presin. Kemi humbur nje beteje por jo luften," thuhej ne deklaraten e tyre.